

KARIKATURA E KARIKATURËS

“O besimtarë, nëse ndonjë njeri i pandershëm u sjell ndonjë lajm, sqaroheni mirë, që të mos e lëndoni (dikë) nga padijenja e pastaj të pendoheni për shkak të asaj që keni bërë”. (Kur’an, 49:6)

Kur nuk mund të shpjegoni diçka që nuk e kuptoni, shpalleni atë si të rastësishme: me këtë keni thënë se dukuria të cilën e shpjegoni i shmanget arsyes njerëzore dhe qëndron jashtë ligjeve të njohura për të, por se është reale. Kështu është zbuluar rastësia si shpjegim për të pakuptueshmen dhe kjo neve na është ofruar si zëvendësim për fatin në kuptimin e paracaktimit. Në këtë kontekst edhe ndodhitë e fundit (themi të fundit sepse nuk duhet harruar fillimin e mijëvjeçarit të tretë me 11 shtatorin, invadimin e Irakut e shumë ndodhi të tjera), nuk janë të rastësishme. I tillë është rasti edhe me botimin e karikaturës ofenduese larg çdo kuptimi domethënës ose artistik dhe vonesës së “muslimanëve” për protesta masive.

Duke përsiatur rreth “jetës muslimane”, për të satën herë na paraqitet pyetja se a thua kjo mënyrë e jetës na është përcaktuar njëherë e përgjithmonë; a është diçka mbikohore pa lidhshmëri të drejtpërdrejtë me situatën historike, pavarësisht nga gjendja konkrete jetësore, apo duhet që gjithnjë rishtas të përkufizohet në dritën e rrethanave të shoqërisë aktuale, pa e harruar aty as biografinë personale. Ose, shprehur me fjalorin tonë aktual: kush janë, si janë dhe si duhet të jenë muslimanët, si dhe çka dëshirojnë të bëjnë? A arsyetohen protestat me traditën e Pejgamberit a.s. dhe me të vërtetë a konsiderohen ato si dëshmi fetare për “shkallën” e besimit?

Hapave të vetëkritikës

Besimtari musliman duhet të ketë vetëdije kritike kur parashtrohet pyetja për raportin e tij me botën, për jetën e tij shpirtërore në shoqërinë e sotme. Pa distancën kritike nga bota nuk është e mundur që në mënyrë të drejtë të zgjidhet problemi i përshtatjes së jetës muslimane ndaj rrethanave të sotme. Thënë konkretisht: në rend të parë duhet ta dijmë qartë se ç’është “muslimane”, çfarë është jeta muslimane, e kjo pastaj të jetë masë për raportin me botën. Kjo është baza për të gjykuarit e natyrës muslimane apo kundërmuslimane të qytetërimit të sotëm, e që pastaj bëhet bazë e mënyrës muslimane të jetesës për sot.

Shoqëria pluraliste demokratike me “lirinë” e pakontrolluar të shprehjes është grackë e cila pengon rritjen shpirtërore të njeriut. Fatmirësisht kjo teori e gabuar është pa themel të thellë në jetën konkrete të njeriut, i cili e di mirë se ka dallim mes të mirës dhe së keqes, mes të vërtetës dhe të rrejshmes, mes të bukurës dhe të shëmtuarës. Ne muslimanët – dhe me ne edhe të gjithë njerëzit mendjehapur – jemi thellësisht të bindur se koncepti i jetës sipas shpirtit musliman është i vetmi i drejtë dhe shembullor për aftësitë e natyrës së njeriut dhe synimet për plotësinë e jetës së suksesshme dhe të lumtur. Shoqëria moderne dhe shteti modern ia arritën të krijojnë botën e tyre – botën dytësore, botën e “demokracisë” dhe të “lirisë” – si realitet të vetëm në të cilin nuk ka vend për realitetin mbinatyor, për “realitetin hyjnor”. Për shkak të këtij horizonti ideor bashkëkohanikët tanë thjesht bëhen të paafte të hapen për “realitetin hyjnor”, ta dëgjojnë dhe ta kuptojnë Fjalën Hyjnore dhe respektin ndaj të dërguarve të Zotit. Mu për këtë arsye edhe filozofi Genon këtë kohë e ka quajtur “epokë e errët”, apo kohë e “dhembjes botërore”, për shkak të “vdekjes” së Zotit (Niçe). Mendime të tilla hasim edhe te intelektualët e vetmuar, por njohës shumë të mirë të kohës dhe dhembjes botërore, si Oswald Spengleri, i cili thotë: “Në vend të njerëzve që i qëndrojnë besnik traditës, të lindur dhe të rritur në tokë, ne sot kemi një lloj të ri nomadësh të cilët vazhdimisht koagullojnë në masa amorge, pa traditë, pa religjion, pa ideale, absolutisht pa imagjinatë, mendjemëdhenj dhe joproduktivë... E gjithë kjo e paralajmëron muzgun e qytetërimit”.

Së pari duhet të pranojmë se koha jonë dhe ky qytetërim i yni nuk janë më botë islame – *Daru-l Islam*. Bota e sotme i pranon vlerat dhe kriteret e jetës që thellësisht dallohen nga ajo botë në të cilën hyri Islami “i ri” dhe që akoma më shumë dallohen nga bota të cilën e krijoi Islami në periudhën e artë të tij. Muslimanët tanë sot janë të detyruar të jetojnë në botën e kulturave, religjioneve dhe ideologjive të ndryshme, në shoqëri pa horizont unik shpirtëror, pa moral të gjithëvlefshëm dhe etikë të gjithëpranuar, dtth. në të a.q. shoqëri “demokratike”, në të a.q. shtete me baza shekullariste të cilët zyrtarisht nuk e predikojnë besimin në Zot dhe nuk e pranojnë Ligjin e Zotit si kriter dhe normë të jetës publike. Në gjuhën zyrtare të shoqërisë moderne nuk paraqiten fjalë apo nocione të natyrës religjioze si: shpallja, pejgamberia, mëshira, mbinatyra, mëkati, ndëshkimi, jeta e amshuar, shpëtimi ose njeriu-krijesë.

Vetëkritika

Mirëpo, para se të lëshohem në interpretimin e ngjarjeve të fundit, dëshiroj t’i përmend disa raste të cilat u kanë rënë mbi kokë muslimanëve e ata kurrsesi të ndalen dhe të mendojnë ç’jemi duke bërë?!? Kohën e Pejgamberit a.s., fyerjet e pandërprera të Ebu Lehebit, shpifjet më të mallkuara e deri te sulmi fizik mbi të me gurë (në Taif). Ose sot: pse dhe si ndodhën “Revolucioni” islamik në Iran? Çka i solli ky “Botës islame”? Pastaj lufta Iran-Irak? Lufta Irak-Kuvajt? (E mos t’i përmend luftërat Izrael-mbarë bota arabe). Kujtojeni ngjarjen në Hama, Siri, në

vitin 1981 – masakrës së paharruar kundër muslimanëve, për të cilën as që dihet saktësisht se çka ka ndodhur; burgosja dhe shfarosja e vazhdueshme e “Vëllezërve Muslimanë” në Egjipt; paraqitja e “Mehdiut” dhe depërtimi me armë në Bejtullah në Mekke. E ç’të themi për shprehjen “e lirë” nëpër vendet e “Botës islame”? Libiasit dhe irakienët nuk kanë pasur mundësi të marrin frymë; e njëjta gjë ka ndodhur në Siri, Egjipt e në shumë vende të tjera të hapësirës “arabe-muslimane”. E nga ana tjetër, sa herë që ndodh diçka kundër muslimanëve jashtë “Botës islame”, ata bëjnë huxhum drejt ambasadave dhe konsullatave të huaja (të cilat më vonë do të rindërtohen nga vetë qeveritë vendase?!?), e persona me fytyra të mbuluara kidnapojnë njerëz dhe ua presin kryet para kamerave me “La ilahe il-lallah” në ballë. Për fat të keq, shumë burime të shkruara dhe dokumentuara tregojnë se më tepër muslimanë palestinezë janë vrarë nga vet arabët, të cilët perëndimi i njeh si “muslimanë” sesa nga të tjerët, e mos të flasim për apatriditetin e tyre. Shumë vende të kësaj hapësire evro-aziatike-afrikane akoma nuk janë në gjendje ta kuptojnë nevojën e shtetasve të tyre për liri dhe shprehje të lirë në gjuhën amtare. Vallë mjafton që të thuhet se forcat sekrete “masonike” e të tjera dhe interesat e fuqive të mëdha botërore janë duke i bërë të gjitha këto dhe duke e shkatërruar “botën islame”, pa shikuar edhe në vetveten? Tekefundit, si të shpjegohen të gjitha traumat nëpër të cilat kaluan institucionet e Bashkësisë Fetare Islame të ne, plot terror e shpifje në formë pamfletësh “pa” autorë. Kush i bëri të gjitha këto, jomuslimanët? A nuk është kjo absurditet?!?

... Në gjithë këtë – absurditeti...

Njëri nga simptomat kryesore të muzgut të ndonjë kulture të caktuar është zhdukja e njohjes për domethëniet e përmbajtjeve të asaj kulture në vetëdijen e mbrojtësve të saj. Siç dëshmon për këtë shqyrtimi në të gjitha periudhat e dekadencës së kulturave, shenjat, simbolet dhe idetë, sipas rregullës, zgjasin duke iu falënderuar inercionit të thjeshtë dhe transmetimit material, mirëpo vetëdija e bashkëkohanikëve të atyre periudhave bëhet gjithnjë e më e largët nga mundësia për t’i njohur domethëniet burimore të përmbajtjeve të transmetimit. Kështu, për shembull, shumësia e gabimeve të cilat i bënin gdhendësit mbi gurë të simboleve dhe shenjave në monumentet e periudhave të fundit të kulturave “parakolumbiane”, qartë dëshmon se as ata njerëz, e as punëdhënësit e tyre, kastat klerike, nuk e kanë ditur domethënien e asaj që e kanë transmetuar.

Kjo dukuri e zhdukjes së domethënies shkakton një kundërmasë të pavetëdijshme: periudhat e dekadencës i karakterizon përpjekja e jashtëzakonshme intelektuale e drejtuar kah depërtimi në domethëniet e përmbajtjeve të kulturës. Më kot, ngase të gjitha diskutimet për domethëniet, shpeshherë edhe të ashpra, vetëmse i përshpejtojnë proceset e largimit nga domethëniet në fjalë. Dhe ngaqë në rastet e tilla aftësitë shpekullative të shpirtit tentojnë ta kompensojnë harresën e qenies, në vend të njohjes së domethënieve burimore, liria e arbitraritetit të shpirtit shpie drejt

pafundësisë së figurave fantastike dhe përbindëse, që shpesh janë vetë kundërshtitë e së vërtetës.

Ky afsh hermeneutik kontribuon në përhapjen dhe përshpejtimin e procesit të dekadencës, sepse i shterron të gjitha energjitë, madje edhe ato të cilat janë të domosdoshme për krijimin. Në vend që ta shpëtojë të tashmen e vet, në vend që të përgatitet për ardhmërinë e vet, kultura e dekadencës e tëra është e kthyer kah diskutimet për domethëniet e përmbajtjeve të së kaluarës. Prandaj fundi i kulturës së “fundit” të perandorive të mëdha në të kaluarën është në shenjën e bollëkut të gramatikëve, retorikëve, shkruarësve, klasifikuesve etj. Në mënyrë analogjike, edhe kultura moderne është në shenjën e mbizotërimit të disiplinave analitike dhe introspektive. Kjo zhvendosje e gravitimit të kulturës kah këto disiplina pikërisht i përgjigjet rrezikut të cilin e përmban fenomeni i humbjes së domethënieve, megjithëse rezultati është i kundërt me ato orvatje të pavetëdijshme të energjive të fundit të kulturës që perëndon. Bëhet fjalë për fenomenin e përkufizuar me fjalët “bota si domethënie në shkatërrim” (Ernst Jünger). Në atë botë të domethënieve në shkatërrim kushti kryesor i ekzistencës është absurditeti (p.sh. absurditeti i fjalës së Hallaxhit “zoti yt është nën këmbët e mia”). Në botën e absurditetit njeriu është një i huaj i cili nuk e njeh as vetveten, ai është “pasojë” e domosdoshmërisë dhe absurditetit.

Për dallim nga përmbajtjet e botës moderne, të cilat shpesh janë në shenjën e absurditetit të pavetëdijshëm, përmbajtjet e kulturës moderne, falë aftësive të jashtëzakonshme introspektive, i karakterizon pikërisht përcaktimi i vetëdijshëm për afirmimin e absurditetit. Kjo kulturë e absurditetit ka kryer ndikim edhe mbi masat e gjera, të cilat idetë dhe sendet e absurditetit tashmë i kanë pranuar si shtylla të ekzistencës së tyre, si objekte të mjedisit të tyre të përditshëm.

Kjo bindje është mjaft indikative për funksionin e absurditetit në kulturën moderne, sepse në disa disiplina tradicionale, si në misticizmin, përdorimi i absurditetit ka pasur qëllim krejtësisht tjetër. Në misticizëm përgjigjja absurde e mësuesit në pyetjet e nxënësit te ky i fundit shkakton aktivitet të përforcuar mendor, si kusht i thyerjes së kufijve të vetëdijes dhe njohjes. Këtu absurditeti shkakton atë shqetësim në të cilin digjen kufizimet, duke hapur udhën kah Absoluti. Në kulturën moderne absurditeti qetëson çdo shqetësim para iluzioneve, duke kontribuar në stabilitetin dhe zgjatjen e atyre iluzioneve. Këtu absurditeti është mjet gjumëndjellës për çdo shqetësim të njohjes, efikasiteti i të cilit gjendet edhe në bindjen e përgjithshme në vlerën e absurditetit, edhe pse ajo vlerë dëshmohet vetëm në mënyrë tautologjike. Kështu absurditeti pamundëson njohjen e rreziqeve të mëdha, duke i shterrur energjitë që do të mund t'i largonin ato rreziqe. Ironia e fatit është se pikërisht absurditeti është shenja e parë e rrezikut në të cilin mund të hasë vetëdija e drejtuar kah njohja e gjithësisë së rreziqeve. Atëherë si është e mundshme që protestat të ngrihen mbi këtë formë të absurditetit, pos nëse edhe vetë nuk janë absurde në emër të besimit.

...dhe shoqëria “demokratike”

Varshmëria e njeriut modern nga mjetet e komunikimit masiv në shoqëritë “demokratike”, por edhe në “të tjerat”, është rritur deri në përmasa kritike. Shpeshherë ai njeri nuk është i aftë të mendojë dhe veprojë pa sugjerimin e *mas mediuveve*: ekzistenca e tij varet nga ato urdhëresa elementare, kështu që futja e çfarëdo “dykuptimësie” të vetëdijshme, e çfarëdo sugjerimi për anulimin e vendimit për kohë të pacaktuar të instrospektimit dhe analizës – do të kishte pikërisht pasoja katastrofike. Për njeriun modern realitetin dhe sigurinë në ekzistimin e atij realiteti e ofrojnë *mas mediuveve*, kështu që futja e çfarëdo parimi të dyshimit në mjetet për komunikim masiv do të mund ta shkatërronte edhe atë iluzion të fundit, duke shkaktuar pikërisht atë shkëputje të komunikimeve, si shkak i shembjes së tërë sistemit, të cilit i takon edhe mendimi “humanist” si antitezë iluzore e brendshme. Ky është thelbi i rezistencës të cilën publiku masiv e ka ndaj të gjitha programeve “kulturore” të *mas mediuveve*: në programet e tilla njeriu i masës, njeriu i “turms së vetmuar”, në mënyrë të pavetëdijshme ndjen rreziqet dhe kërcënimet ndaj pikëmbështetjeve të fundit iluzore të ekzistencës së tij. Për të qenë më e plotë fotografia e mjerimit të njeriut modern, fotografia të cilën e sugjerojnë potencialet “apokaliptike” të *mas mediuveve*, kësaj paraprakes duhet shtuar edhe faktin se *mas mediuveve* kushtëzojnë jo vetëm strukturën e tij psikike, por edhe sjelljen e tij fizike. Në këtë drejtim shembull klasik paraqet radio emisioni i Orson Wellsit i cili paralajmëroi invadimin nga Marsi, duke shkaktuar panik dhe ikje masive nga Nju Jorku, ashtu që policët me muaj të tërë kërkonin të ikurit nëpër malet përreth, me qëllim që t’i bindin për të kundërtën dhe t’i kthejnë në qytetërim.

Si realistë, duhet të pranojmë se për shoqërinë masive demokratike me rëndësi qenësore është që ajo deri-diku të funksionojë, mos të zhytet në kaos. Garantimi i “funktionalitetit” të tillë shpesh është i mundshëm vetëm me kusht të mosrespektimit të ligjit të Zotit. Sot ekziston vartësia e pashmangshme mes prodhimit dhe harxhimit të cilit i janë nënshtruar të gjithë qytetarët, secili në mënyrën e vet dhe në vendin e vet. Kjo përmbajtje nuk merr parasysh çdo koncept të veçantë religjioz dhe etik të jetës. Shoqëria si “mbiautoritet” ose shteti si “zot i vdekshëm” e tolerojnë vetëm atë që kontribuon për funksionimin e proceseve shoqërore. Shteti do ta ndalojë çdo gjë që e konsideron të urtë dhe të sigurtë për jetën e përbashkët, qoftë fjala edhe për të vërteta të shpallura. Të gjithë pra gjendemi nën detyrimin e pjesëmarrjes dhe të bashkëpunimit në procesin shoqëror-ekonomik. Mos të bashkëpunohet për shumicën do të thoshte të rrezikohet jeta personale, e madje edhe e mira e përgjithshme. Që këtu është e arsyeshme të parashtrahet pyetja: A jemi të lirë në atë masë që të mundemi pa kurrfarë brrejtjeje të ndërgjegjes “të lëmë çdo gjë dhe të ndjekim Kur’anin dhe Sunnetin”? Sipas natyrës së vet shoqëria demokratike nuk na kthen me detyrim nga ndjekja e rrugës së drejtë, edhe pse është e vërtetë edhe ajo se nuk na mundëson liri pozitive që ta bëjmë këtë pa pasoja më të mëdha negative për jetën tonë. E dijmë se në kohën e komunizmit pasoja e ndjekjes së çfarëdo feje për besimtarët automatikisht nënkuptonte degradim në sferën e të drejtave qytetare dhe njerëzore. Në shoqërinë

demokratike ekzistojnë mekanizma më subtilë shoqërorë-politikë të cilët veprojnë në kuptim të njëjtë. Kushdo që në tërësi jeton jetën e vet si musliman, shumë shpejt do të gjendet në një ballafaqim të caktuar me “rrahjen” thelbësore të jetës së kësaj shoqërie, qoftë në sferën ekonomike, shkencore, kulturore ose politike. Kjo konkretisht do të thotë se shumica e besimtarëve vazhdimisht gjenden në situata detyruese të arritjes së kompromisit me mënyrën e jetës, e cila në thelb është e papajtueshme me etosin musliman. Që këtu edhe detyrimi për vetëm një identifikim të pjesërishëm me jetën muslimane. Është vështirë që mënyra e tillë e jetës të konsiderohet si ndjekje e Kur’anit/Sunnetit. Edhe këtu vlen rregulla e njëjtë që vlen për miqësinë dhe dashurinë: të qënit gjysëm mik ose të dashuruarit e pjesërishëm – që është absurde. Ngjashëm do të ishte me rastin e të qënit gjysëm musliman dhe gjysëm “njeri modern shekullarist”.

Si përfundim

Liria e të menduarit dhe besimit të garantuara me ligj për pasojë ka se çdokush përdor fjalën “Zot” ashtu siç dëshiron, që ndërjegjen e vet personale ta konsiderojë për gjykatës suprem në përcaktimin e asaj se ç’është e mirë e ç’është e ligë; që sipas rrethanave ta dojë Zotin, e pastaj ta urrejë ngase i frikësohet. Kjo dhe të ngjashmet mund të ndodhin në shoqërinë demokratike pa kurrfarë dëmi intelektual, pa kurrfarë rreziku ndaj personalitetit individual, duke harruar përgjegjësinë e identitetit fetar e kulturor, ndërsa e gjithë kjo bëhet në dritën e lirisë individuale e cila çdo individ e bën zot të vetvetes dhe të mjedisit. Në horizontin e tillë njerëzit lehtë arrijnë bindjen se nuk ka lidhje se kush si jeton, ose në çka dhe në kë dikush beson, sepse çdo gjë është e lejuar dhe kësisoji në njëfarë mënyre zyrtarisht e vërtetuar se çdo gjë është njësoj e vlefshme, se nuk ekziston Një e Vërtetë e vetme, se nuk ekziston morali i vetëm i drejtë. Të tillë mund të jenë “besimtarët” e rock and roll “religjiozitetit” të cilët mbahen në gjendje transi dhe pasiviteti të vazhdueshëm, me një varg të pafundshëm të pasojave degjenerative, e që më së qarti manifestohet me vetë “sipërfaqen” e fenomenit, sjelljen devirilizuese dhe efeminizuese, ku flokët e gjata nuk janë vetëm shprehje e ndryshimeve të modës por edhe të atyre qenësoreve. Këtë e propagon pluralizmi si ideologji e shoqërisë demokratike, të cilën fatkeqësisht edhe ne si besimtarë në një mënyrë të (pa)vetëdijshme jemi duke e përvetësuar. Mirëpo, megjithë koklavitjen e demokracisë, e cila dita-ditës po zbehet, ne si muslimanë lidhjen me Shpalljen dhe traditën pejgamberiane gjithsesi duhet të përpiqemi ta zbatojmë në sferën e të menduarit dhe të jetuarit.

Kodet kryesore për të qenë musliman në literaturën e përgjithshme të Islamit janë: të jeshë i lirë, i mençur dhe i pjekur. Mbi këtë ndërtohet edhe leximi i porosive të Pejgamberit a.s. në Haxhin Lamtumirës: “angazhoheni veten me punë të mëdha”, apo “musliman i mirë është ai nga goja dhe dora e të cilit janë të sigurt të tjerët”, ose i imperativit kur’anor nga fillimi i këtij shkrimi: “verifikoni lajmet e të pandershmëve...” dhe “Kurse robërit e të Mëshirshmit janë ata të cilët nëpër tokë

ecin qetë, ndërsa kur u drejtohen injorantët, thonë: ‘Paqe e qetësi!’” (Kur’an, 25:63), ose që “mos të fyhen zotat e të tjerëve”. Atëherë, mbi çka bazohen këta vetëprotestues të cilët për arsye të pakujdesit të tyre dhe “papërgjegjësisë” krijojnë vetëmse pasiguri, urrejtje dhe ngjallin fitnen e mallkuar. Për kë atëherë vlen thënia profetike: “O Zot faljau se ata nuk e dijnë”?!? Duhet të jemi realë e mos të kërkojmë të pamundurën: me “dhunë”, “terror” dhe “vërshime” drejt ambasadave nuk mbrohet Islami, e aq më pak muslimanët.

Shkup, 15.02.2006